



Në bazë të Programit për aktivitetet e Qytetit të Shkupit nga fusha e bashkëpunimit me shoqata civile dhe fondacione për vitin 2019 (Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit numër 27-591/1 data 23.01.2019) Qyteti i Shkupit shpall

**Thirrje publike
për grumbullimin e kërkesave
për shfrytëzimin e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2019,
të dedikuara për financimin e aktiviteteve programore
të shoqatave dhe fondacioneve**

Shpërndarja e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2019 Nënprogrami EO, nënzëri 463190 – Transferime deri te shoqatat joqeveritare, Nënprogrami EO, nënzëri 463110 – mbështetja e iniciativave dhe manifestimeve të shoqatave dhe fondacioneve të dedikuara për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave civile dhe fondacioneve, do të kryhet në përputhje me Kodeksin e praktikave të mira për përkrahjen financiare të shoqatave civile dhe fondacioneve (“Gazeta zyrtare e RM”, nr. 27/871/1), dhe në bazë të Programit për aktivitetet e Qytetit të Shkupit nga fusha e bashkëpunimit me shoqata civile dhe fondacione për vitin 2019 dhe kritereve dhe prioritetet të dhëna në këtë thirrje publike.

I. Lloji i projekteve të cilat do të përkrahen

Në suazat e kësaj Thirrjeje publike do të përkrahen nga ana financiare:

- a) Aktivitete programore të shoqatave dhe fondacioneve me vlerë të përgjithshme 2.500.000,00 denarë, nëpërmjet grandeve për projekte nga fushat prioritare të mëposhtme:
- Mbrojtja e ambientit jetësor dhe përkrahja e shprehive të shëndetshme jetësore
 - Zhvillimi i qëndrueshëm i Qytetit të Shkupit (efikasitet energjetik, transport, burime të rinovueshme të energjisë, qytet i mençur – inovacione)
 - Ngritja e vetëdijes dhe përkrahja e iniciativave për shfrytëzimin e transportit publik nga ana e qytetarëve, përdorimi i biçikletës si mjet transporti, ngritja e vetëdijes së qytetarëve për mjedis jetësor të pastër, seleksionimi i mbetjeve dhe ekonomi cirkulare
 - Rritja e pjesëmarrjes së sektorit civil në procesin e krijimit dhe zbatimit të politikave
 - Përkrahja e pjesëmarrjes aktive në iniciativat rajonale, projekteve dhe

projekteve nga programet europiane

- Zhvillimi i koncepteve për avancimin e bashkëpunimit ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe sektorit civil, si dhe në vetë sektorin civil
- Përkrahja e iniciativave për sipërmarrje sociale

Vlera minimale: 60.000,00 denarë

Vlera maksimale: 300.000,00 denarë

b) Manifestime të shoqatave dhe fondacioneve, me vlerë të përgjithshme 500.000,00 denarë, nëpërmjet grave për projekte nga fushat prioritare të mëposhtme:

- Përkrahje e manifestimeve të lidhura me mbrojtjen e mjedisit jetësor
- Përkrahje e manifestimeve për kremtimin e ditëve nga fusha e shëndetësisë
- Përkrahje e manifestimeve dhe evenimenteve me rëndësi për Qytetin e Shkupit
- Dita e shoqatave dhe fondacioneve;

Vlera minimale: 30.000,00 denarë

Vlera maksimale: 150.000,00 denarë

2. Korniza kohore dhe mjetet e përgjithshme të parashikuara/në dispozicion

Mjetet kanë të bëjnë për vitin 2019.

Shfrytëzimi i mjeteve të ndara do të specifikohet në Kontratën ndërmjet shoqatës/fondacionit dhe Qytetit të Shkupit.

3. Kriteret themelore organizative

Kriteret themelore organizative që duhet t'i plotësojnë shoqatat dhe fondacionet që marrin pjesë në këtë thirrje janë:

- Të jenë të regjistruara në përputhje me Ligjin për shoqatat civile dhe fondacionet me seli në Shkup;
- Të mos kenë fituar mjete ose të kenë depozituar fletëparaqitje nga/pranë ndonjë organi tjetër të administratës shtetërore ose burime të tjera për të njëjtin qëllim dhe aktivitetet për të cilat depozitojnë fletëparaqitje, që do të nënkuptonte financim të dyfishtë të aktiviteteve të njëjta nga burime të ndryshme.

4. Vlerësimi i kualitetit të projekteve

Vlerësimi i kualitetit të projekteve të shoqatave dhe fondacioneve të cilat plotësojnë kriteret themelore organizative, do të bëhet në bazë të kriterëve programore vijuese:

Kritere	Pikët maksimale
1. Struktura organizative dhe resurset	40
1.1. A kanë shoqata civile dhe fondacioni strukturën e nevojshme dhe resurset humane për realizimin e projektit (të punësuar, vullnetarë aktiv, persona të angazhuar me honorar, përfaqësim të balancuar të grave dhe burrave në organizatë)	10
1.2. Ekspertë të cilët marrin pjesë në realizimin e projektit	10
1.3. A disponon shoqata civile dhe fondacioni me ambiente zyrash dhe pajisje teknike për realizimin e projektit	10
1.4. A e tejkalon buxheti vjetor i shoqatës dhe fondacionit për vitin e fundit të kalendarit vlerën e grandit	10
2. Bashkëfinancimi i projektit	10
2.1. A siguron shoqata dhe fondacioni përqindje të pjesëmarrjes së saj në realizimin e projektit	10
3. Kualiteti i projektit	50
3.1. Sa do të kontribuojë qëllimi i përgjithshëm i projektit për realizimin e prioriteteve të dhëna, sa është i qartë dhe i përcaktuar në mënyrë adekuate	10
3.2. Zgjidhje kualitative dhe inovative të ofruara në propozim - projekt	10
3.3. Sigurimi i përfshirjes së institucioneve dhe organizatave të tjera	10
3.4. A është i qartë dhe i realizueshëm plani për realizimin e projektit	10
3.5. A është real plani financiar i propozuar (përshkrimi i shpenzimeve nëpër kategori, pozicione përshtatet me çmimet e tregut).	10

Çdo fushë e kriterëve të veçanta programore do të vlerësohet me 1 pikë, 5 pikë ose 10 pikë, me këtë kuptim: 1-jo; 5-pjesërisht dhe 10-po.

5. Dokumentacioni i nevojshëm të cilin shoqata/fondacioni duhet ta depozitojë së bashku me Fletëparaqitjen për përkrahje financiare të shoqatave dhe fondacioneve.

Përveç Fletëparaqitjes për përkrahje financiare të shoqatave dhe fondacioneve, që duhet të plotësohet (me shkronja shtypi në alfabetin cirilik), të nënshkruar nga ana e përfaqësuesit të shoqatës ose fondacionit dhe të verifikuar me vulë të shoqatës ose fondacionit, shoqata ose fondacioni detyrimisht duhet t'i depozitojnë dokumentet e mëposhtme:

- Statuti i shoqatës ose fondacionit;
- Fotokopje e vendimit për regjistrimin e shoqatës ose fondacionit;
- Formular kompjuterik i plotësuar për Propozim-projektin;

- Raport për mjetet e fituara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit në vitin e kaluar fiskal si dhe mënyrën e realizimit (nëse organizata ka qenë shfrytëzues i mjeteve të ndara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2018);
- Raport vjetor i shoqatës ose fondacionit për vitin 2018;
- Fotokopje nga llogaria përfundimtare e fundit;
- Vërtetim për tatime të paguara, i lëshuar nga organet tatimore.

6. Dokumentacioni përcjellës

Shoqatat dhe fondacionet të bashkëngjitur mund të depozitojnë edhe dokumentacionin përcjellës në vijim:

- biografi profesionale të ekspertëve që do të angazhohen në realizimin e projektit,
- listë referuese ose dëshmi (p.sh.:kontratë e nënshkruar) për më së paku 2 projekte të realizuara nga fusha për të cilën aplikohet,
- së paku dy mendime/referenca nga partnerë ose donatorë për realizimin e projekteve të mëparshme, dhe
- përkrahje me shkrim nga organizata ose institucione të tjera për të cilat është planifikuar që të marrin pjesë në realizimin e projektit.

Shoqatat civile dhe fondacionet mund të depozitojnë vetëm një fletëparaqitje për përkrahje financiare për projekt ose manifestim.

Vërejtje: Fletëparaqitjet me dokumentacionin jo të plotë ose që depozitohen pas përfundimit të afatit të parashikuar nuk do të shqyrtohen! Shtojcat e depozituara nuk kthehen.

7. Afati dhe mënyra e depozitimit të fletëparaqitjeve

Afati për depozitimin e fletëparaqitjeve është deri më 22.02.2019 deri në orën 15.

8. Periudha e realizimit të projekteve

Deri më 1 (një) dhjetor 2019

Fletëparaqitja me dokumentacionin e plotë duhet të depozitohet nëpërmjet postës, në zarf të mbyllur në adresë: **Qyteti i Shkupit, Seksioni për bashkëpunim dhe përkrahjen e shoqatave civile dhe fondacioneve, bul. "Ilinden" nr. 82, 1000 Shkup** nëpërmjet arkivit të Qytetit të Shkupit deri në orën 15 (me shënimin – Seksioni për bashkëpunim dhe përkrahjen e shoqatave civile dhe fondacioneve – Fletëparaqitje për thirrje publike).

Shoqatat ose fondacionet pjesëmarrëse në thirrjen publike do të njoftohen për rezultatet në një afat prej 10 ditësh nga dita e sjelljes së Vendimit për ndarjen e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2019, të dedikuara për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve.

Fletëparaqitja për përkrahje financiare të shoqatave dhe fondacioneve dhe Formulari për Propozim – projektin, mund të merren në ambientet e Qytetit të Shkupit, Sektori për bashkëpunim dhe përkrahjen e shoqatave civile dhe fondacioneve dhe në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk. dhe www.skopje.gov.mk/nvo

Pyetje për sqarime plotësuese mund të parashtrohen në formë të shkruar ose në formë elektronike pranë Seksionit për bashkëpunim dhe përkrahjen e shoqatave civile dhe fondacioneve.

Kontakt: Seksioni për bashkëpunim dhe përkrahjen e shoqatave civile dhe fondacioneve, Tel: (02) 3 207-506, e-mail adresa: antonio.karalanov@skopje.gov.mk saranda.bekiri@skopje.gov.mk.